



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 784/5 prot.

Tiranë, më 27. 07 . 2022

V E N D I M

Nr. 151, datë 27 . 07 . 2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 80 Regj, datë 19.05.2022, të shtetasit L. P, kundër Këshillit të Ministrave, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “moshës” dhe “gjendjes ekonomike”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues është banor i qytetit të Korçës dhe ka moshën 80 vjeç. Ai ka paraqitur ankesë pranë KMD-së lidhur me problematikën e tij, e cila konsiston në faktin se për shkak të moshës, mungesës së një telefoni të përshtatshëm, ai nuk mund të realizojë aplikimin online lidhur me shërbimet që i nevojiten në portalin “e-Albania”. Ai shprehet se i është dashur të aplikojë tek ky portal lidhur me shtesën e pensionit të tij tek Sigurimet Shoqërore dhe për shkak se nuk ka mundur ta aksesojë këtë shërbim, i është dashur të paguajë 1000 lekë për të marrë këtë shërbim.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe hapjen e zyrave për të marrë shërbimet për qytetarët që nuk e kanë të mundur aksesin për ta marrë nga portal “e-Albania”.

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”², të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkaqe të specifikuara, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 7, i LMD, të ndryshuar, parashikon shprehimisht: “1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, të tij parashikon se: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtësën LMD.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga LMD.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës nr. 784/1 prot., datë 30.05.2022, Komisioneri i është drejtuar Këshillit të Ministrave, duke kërkuar informacion sa i përket pretendimeve të ngritura nga subjekti ankues.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Këshilli i Ministrave me shkresën nr. 3122/1 prot., datë 28.06.2022, vuri në dispozicion të Komisionerit informacionin e kërkuar, duke sqaruar si vijon:

“Kryeministria, më datë 15.06.2022, i kërkoi në rrugë elektronike Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Korçë, për sa më poshtë vijon:

- të verifikojë pretendimet e ankuesit;
- të kontaktojë sa më shpejt me ankuesin, ta ndihmojë me pjesën e pakryer të aplikimit (nëse ka) dhe t'i sqarojë se te cila zyrë apo nëpunës brenda institucionit të DRSSH Korçë, duhet të drejtohet për të aksesuar të gjitha shërbimet për të cilat mund të ketë nevojë edhe në vijim, e që ofrohen nga portali qeveritar “e-Albania”, duke e qartësuar edhe për dokumentet që sigurohen nga institucionet apo aplikuesit;
- informacion nëse ka pasur problematika lidhur më vështirësitë/pamundësinë e aksesimit të portalit “e-Albania” dhe si janë zgjidhur ato”.

Nëpërmjet e-mailit, DRSSH Korçë, i është përgjigjur Kryeministrit, duke e informuar, ndër të tjera, si më poshtë vijon:

“Në përgjigje të e-mailit tuaj në lidhje me masat që janë marrë nga DRSSH Korçë, në lidhje me këto situata, ju bëjmë me dije se deri tani nuk janë konstatuar raste të ngjashme.

Sa i përket masave të marra nga ana jonë, ju bëjmë me dije se në çdo agjenci të Sigurimeve Shoqërore nën juridiksionin e DRSSH Korçë, janë afishuar numra telefoni të specialistëve të DRSSH-së, të cilët i ndihmojnë nëpërmjet telefonit qytetarët që hasin vështirësi në aplikim.

Në lidhje me rastin për të cilin na jeni drejtuar, ju bëjmë me dije se ky shtetas ka aplikuar on-line vetëm për kompensimin për energji elektrike më datë 13.05.2022, kompensim të cilin ky shtetas e përfiton në vijimësi”.

2. Komisioneri, në vijim të përgjigjes së DRSSH Korçë, nëpërmjet punonjësës së Zyrës Rajonale Korçë të KMD-së, bëri një verifikim të situatës pranë ambjenteve të DRSSH Korçë. Nga këqyrja dhe verifikimi në terren u konstatua se në ambientet e jashtme të DRSSH Korçë ishin të afishuara numrat e telefonit të specialistëve të DRSSH-së, me qëllim ofrimin e ndihmës për qytetarët që hasin vështirësi në aplikim³.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm.

A. 1. Lidhur me pretendimin e ankuesit për diskriminim nga Këshilli i Ministrave.

Në zbatim të ligjit nr. 107/2021 *“Për Bashkëqeverisjen”*, Këshilli i Ministrave, ka miratuar Vendimin nr. 252, datë 29.04.2022 *“Për procedurat e ofrimit të shërbimeve on-line nga institucionet shërbimofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre”*.

Ky vendim ka dalë në zbatim të nenit 61, të ligjit nr. 107/2021 *“Për Bashkëqeverisjen”*, i cili parashikon se: *“Ofrimi i shërbimeve nga të gjitha institucionet shërbimofruese, aplikimet e të cilave realizohen nëpërmjet platformës “e-Albania”, do të realizohet vetëm elektronikisht, duke siguruar lëshimin e dokumentit përfundimtar me vulë elektronike ose nënshkrim elektronik...”*, dhe përcakton në mënyrë të detajuar procedurat e ofrimit të shërbimeve on-line.

Kështu neni 3, shkronja a) e kësaj VKM-je ka parashikuar se:

“3. Ky vendim ka për objekt rregullimin e:

- a) *procedurës së ofrimit të shërbimit në mënyrë elektronike nga institucionet shtetërore, duke lëshuar dokumentin përfundimtar elektronik, me nënshkrim ose me vulë elektronike, në favor të subjektit kërkuar”*.

Në nenin 30, të kësaj VKM-je parashikohet se: *“Ngarkohen institucionet shtetërore për të miratuar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, rregullore me karakter të brendshëm për mënyrën e zbatimit nga ana e punonjësve dhe strukturave të tyre përgjegjëse të detyrimeve që burojnë nga ky vendim”*.

Lidhur me pretendimet e subjektit ankues për diskriminimin e tij nëpërmjet VKM nr. 252, datë 29.04.2022 *“Për procedurat e ofrimit të shërbimeve on-line nga institucionet shërbimofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre”*, sa i takon mosofrimin të shërbimit të kërkuar nga ana e

³ Referuar e-mailit datë 06.07.2022 të Zyrës Rajonale Korçë/KMD.

DRSSH Korçë, Komisioneri vlerëson se, ankuesi nuk është diskriminuar për shkak të parashikimeve (apo mosparashikimeve) të kësaj VKM-je, pasi ky vendim ka parashikuar shprehimisht se ngarkohen institucionet shtetërore për të miratuar, akte të brendshme për mënyrën e zbatimit nga ana e punonjësve dhe strukturave të tyre përgjegjëse të detyrimeve që burojnë nga ky vendim. Pra, kompetencat për mënyrën e zbatimit nga ana e punonjësve dhe strukturave të tyre përgjegjëse të detyrimeve që burojnë nga ky vendim, i kalojnë të gjitha institucioneve shtetërore shërbimofruese, duke u lënë një hapësirë diskrecionare secilit lidhur me mënyrën e individualizuar, në varësi të natyrës së punës e veprimtarisë së institucionit, menaxhimit të burimeve njerëzore etj.

A. 2. Lidhur me trajtimin e kërkesës së ankuesit nga DRSSH Korçë.

Megjithëse subjekti e ka orientuar ankesën e tij ndaj vendimit të Këshillit të Ministrave, Komisioneri, për arsyet e cilësuar më sipër, vëren se subjekti përgjegjës për trajtimin e kërkesës për ofrimin e shërbimit të ankuesit është DRSSH Korçë.

Në këtë kontekst, është analizuar sjellja institucionale e DRSSH Korçë, në raport me të drejtën e ankuesit dhe detyrimin institucional për t'i ofruar atij shërbimin përkatës, sipas parashkimeve ligjore.

Bazuar në parashtrimet dhe dokumentacionin e depozituar nga palët, Komisioneri vëren se:

Subjekti ankues, i datëlindjes 05.05.1942, është përfitues i pensionit të plotë të pleqërisë, si dhe i kompensimit të shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike e lëndëve djegëse⁴.

Pretendimi i ankuesit, konsiston në faktin që atij nuk i është ofruar shërbimi i kërkuar nga DRSSH Korçë. Ai ka pretenduar se ka vajtur në ambjentet e DRSSH Korçë, për të aplikuar lidhur me shtesën e pensionit dhe nuk i është mundur ky shërbim pasi punonjësi i ka thënë se aplikimi bëhet vetëm on-line.

Bazuar në VKM nr. 252, datë 29.04.2022 “Për procedurat e ofrimit të shërbimeve on-line nga institucionet shërbimofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre”, për ofrimin e shërbimeve on-line, nga data 1 maj 2022, ofrimi për rreth 95% të shërbimeve publike kryhet on-line, duke mbyllur sportelet për marrëdhëniet fizike me qytetarët në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimit dhe të transparencës.

Sipas shkresës me nr. 3122/1 prot., datë 28.06.2022, të Kryeministrit, rezulton se, ndër problematikat e evidentuara përfshihen edhe ato të vështirësive të disa qytetarëve për të

⁴ Referuar Mandat Pagesës së Postës Shqiptare, me nr. serial 0053991403, datë 11.05.2022.

marrë shërbimet on-line për shkak të moshës dhe/apo mungesës së një pajisjeje elektronike të përshtatshme. Në përgjigje të kësaj problematike, çdo institucion përgjegjës për ofrimin e shërbimeve on-line ka vënë në dispozicion një apo disa punonjës të cilët ndihmojnë çdo qytetar, i cili për arsye të ndryshme ka vështirësi për të siguruar në mënyrë të pavarur shërbimet on-line.

Në këtë kontekst, mbështetur në informacionin e vënë në dispozicion nga ana DRSSH Korçë, rezultoi se, për t'u ardhur në ndihmë grupeve vulnerabël apo të moshuarve të cilët nuk kanë aftësitë e duhura për të aksesuar portalin "e-Albania", si dhe nuk disponojnë pajisjet e nevojshme elektronike, ka afishuar numra telefoni të specialistëve, të cilët mund t'i asistojnë individët për të marrë shërbimin e kërkuar.

Lidhur me sa ka pretenduar ankuesi, DRSSH Korçë ka informuar se, nga ana e tyre nuk është konstatuar një problematikë e tillë me shtetasin L. P dhe me asnjë subjekt tjetër deri aktualisht, dhe se në rastet që do kishte një problematikë të tillë apo të ngjashme ata kishin marrë masat paraprakisht, duke afishuar numrat e telefonit të specialistëve që do të asistonin individët të cilët do të kishin nevojë për të marrë shërbimin e kërkuar.

Ankuesi në fjalë nuk ka sjellë ndonjë provë a fakt që të vërtetojë faktin se është paraqitur pranë DRSSH Korçë për marrjen e këtij shërbimi dhe se atij nuk i është ofruar ky shërbim. Jo domosdoshmërisht, fakti që ankuesi ka aplikuar on-line me datë 13.05.2022, për një shërbim të cilin e përfiton në vijimësi, të çon në provimin apo marrjen si të mirëqenë të deklaratimit të tij se ky shërbim i është mohuar nga institucioni shërbimofrues dhe është detyruar të paguajë privatisht (në një internet café) për aplikimin. Komisioneri vlerëson se, ndodhemi në kushtet kur pretendimi i ankuesit është thjesht i karakterit deklarativ dhe nuk rezulton i provuar në ndonjë provë, akt apo rrethanë tjetër dëshmuese. Nga ana tjetër, DRSSH Korçë deklaroi shkresërisht se shërbimi i cili pretendohet nga ankuesi se nuk është i ofruar, është i aksesueshëm dhe i mundësuar nga institucioni edhe për kategori të tilla si ankuesi, nëpërmjet afishimit të numrave të telefonit të punonjësve të institucionit në ambjentet e DRSSH Korçë, të cilët janë caktuar për asistimin e këtyre rasteve. Nëse ankuesi do të ishte paraqitur do të ishte asistuar nga punonjësi i DRSSH Korçë, gjë e cila mund të provohet edhe në vijimësi për shërbimet e tjera që mund të ketë nevojë ankuesi dhe çdo individ tjetër në kushte të njëjta a të ngjashme me të.

Nga këqyrja dhe verifikimi i bërë në ambjentet e DRSSH Korçë, nga punonjësja e Zyrës Rajonale Korçë/KMD, deklarimi sa më sipër ka rezultuar i vërtetë, pra në ambjentet e këtij Institucioni ndodheshin të afishuara numrat e telefonit të specialistëve të tij, me qëllimin për ti ofruar asistencën e nevojshme çdo personi që mund të kishte nevojë.

Për rrjedhojë, Komisioneri vëren se, pretendimi i ankuesit për mosofrimin e shërbimit nga DRSSH Korçë, nuk rezulton i provuar.

Në analizë të sa më sipër, Komisioneri gjykon se, nga ana e DRSSH Korçë, ankuesi nuk është ekspozuar ndaj një qendrimi të padrejtë e disfavorizues.

Në këtë kuptim dhe në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjekti ankues nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e DRSSH Korçë.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e DRSSH Korçë, për shkak të moshës dhe të gjendjes ekonomike të ankuesit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues, L. P, në fushën e të mira dhe shërbimeve, nga ana e Këshillit të Ministrave dhe Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Korçë, për shkak të “moshës” dhe “gjendjes ekonomike” të tij.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Të mira dhe shërbime
Shkaku: Gjendja ekonomike dhe moshë
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim